



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA – REPUBLIC OF KOSOVO
GJYKATA THEMELORE PRISHTINË
OSNOVNI SUD PRISTINA – BASIC COURT PRISHTINA

PS.nr.41/2019

GJYKATA THEMELORE NË PRISHTINË - DEPARTAMENTI SPECIAL, Kryetari i Trupit Gjykses, Gjyqtari Valon Kurtaj me Zyrtaren Ligjore Arbnore Idrizi në çështjen penale kundër të akuzuarit E.C. nga P., i akuzuar për veprën penale shmangie nga tatimi në bashkëkryerje nga neni 249 paragrafi 2 lidhur me paragrafin 1 lidhur me nenin 31 të KPK (Kodit Përkohshëm Penal të Kosovës) i akuzuari sipas Aktakuzës së Prokurorisë Speciale të Republikës së Kosovës, Aktakuzës nën numrin PPS.nr.31/2014 të datës 29 dhjetor 2014, jashtë shqyrtimit gjyqësor me datë 8 qershor 2020, merr këtë:

A K T V E N D I M

Ndaj të akuzuarit:

E.C. nga i ati Xh., i lindur me datë .., me vendbanim në P., shqiptar, shtetas i Republikës së Kosovës, i cili sipas informacioneve të Policisë së Kosovës, gjendet jashtë vendit (jashtë Republikës të Kosovës) në Gjermani;

HIDHET Aktakuza Prokurorisë Speciale të Republikës së Kosovës nën numrin PPS.nr.31/2014 të datës 29 dhjetor 2014, e ushtruar ndaj E.C. me shënime personale sikurse të theksuara në këtë aktvendim, i akuzuar për veprën penale shmangie nga tatimi në bashkëkryerje nga neni 249 paragrafi 2 lidhur me paragrafin 1 lidhur me nenin 31 të KPK (Kodit Përkohshëm Penal të Kosovës), për shkak të vjetërsimit absolut të ndjekjes penale.

Pala e dëmtuar, respektivisht Administrata Tatimore e Kosovës, udhëzohet në kontest civil-juridik për realizimin e kërkesës pasurore juridike.

Shpenzimet e kësaj procedure penale bien në barrë të mjeteve buxhetore.

A r s y e t i m

Me datë 29 dhjetor 2014, Prokuroria Speciale e Republikës së Kosovës ka ushtruar Aktakuzën PPS.nr.31/14, kundër të akuzuarve: **N.H.** nga P., i akuzuar për veprën penale shpëlarje e parave nga neni 32 paragrafi 2 pika 2.1, 2.2, 2.3, 2.6 dhe 2.8 e Ligjit për parandalimin e pastrimit të parave dhe financimit të terrorizmit, lidhur me veprat penale keqpërdorim i autorizimeve në ekonomi nga neni 290 të KPRK dhe shmangie nga tatimi nga

neni 249 të KPK, veprën penale keqpërdorim i autorizimeve në ekonomi nga neni 290 paragrafi 2 lidhur me paragrafin 1 të KPRK, veprën penale dokumentet e rrejshme lidhur me tatimin nga neni 314 paragrafi 2 lidhur me paragrafin 1 të KPRK, veprën penale shmangie nga tatimi nga neni 249 paragrafi 2 lidhur me paragrafin 1 të KPK, dhe katër veprave penale të shmangies nga tatimi në bashkëkryerje nga neni 249 paragrafi 2 lidhur me paragrafin 1 lidhur me nenin 31 të KPK; **Sh.T.** nga P., e akuzuar për veprën penale keqpërdorim i autorizimeve në ekonomi nga neni 290 paragrafi 2 lidhur me paragrafin 1 të KPRK, veprën penale dokumente të rrejshme lidhur me tatimin nga neni 314 paragrafi 2 lidhur me paragrafin 1 të KPRK, veprën penale të shmangies nga tatimi në bashkëkryerje nga neni 249 paragrafi 2 lidhur me paragrafin 1 lidhur me nenin 31 të KPK, veprën penale shmangie nga tatimi nga neni 249 paragrafi 2 lidhur me paragrafin 1 të KPK; **F.K.** nga P., i akuzuar për veprën penale të shmangies nga tatimi në bashkëkryerje nga neni 249 paragrafi 2 lidhur me paragrafin 1 lidhur me nenin 31 të KPK dhe **M. P.** nga P., i akuzuar për veprën penale të shmangies nga tatimi në bashkëkryerje nga neni 249 paragrafi 2 lidhur me paragrafin 1 lidhur me nenin 31 të KPK dhe **E.C.** nga P., i akuzuar për veprën penale shmangie nga tatimi në bashkëkryerje nga neni 249 paragrafi 2 lidhur me paragrafin 1 lidhur me nenin 31 të KPK (Kodit Përkohshëm Penal të Kosovës).

Duke vepruar sipas aktakuzës së lartë-theksuar, është caktuar shqyrtimin fillestar gjyqësor, ku në mungesë të sigurimit të prezencës së të akuzuarit E. C. , gjykata ka veçuar këtë çështje penale për këtë akuzuar, ndërsa për të akuzuarit tjerë ka vazhduar me shqyrtimin fillestar dhe atë me datë 14 tetor 2019.

Kryetari i Trupit Gjyqësor nga shkresat e lëndës ka vërtetuar se i akuzuari E.C. në bashkëkryerje me të akuzuarin N. H., është i akuzuar për veprën penale të shmangies nga tatimi nga neni 249 paragrafi 2 lidhur me paragrafin 1 e lidhur me nenin 31 të KPK (Kodit të Përkohshëm Penal të Kosovës). Kjo veprë penale (vepra penale e shmangies nga tatimi nga neni 249 paragrafi 2 lidhur me paragrafin 1 lidhur me nenin 31 të KPK) është e ndëshkuar me dënim me burgim në kohëzgjatje prej 6 muaj deri më 5 vjet.

Sipas dispozitave të nenit 90 paragrafi 1 pika 4 të KPK (Kodit Përkohshëm Penal të Kosovës), është përcaktuar se për veprat penale për të cilat parashihet dënimi me burgim me më shumë se 3 (tre) vjet e deri në 5 (pesë) vjet, ndjekja penale nuk mundë të ndërmerret pas kalimit të aftit kohorë prej 5 (pesë) vjet nga koha e kryerjes së veprës (parashkrimi relativ i ndjekjes penale), ndërsa neni 91 paragrafi 6 i KPK (Kodit Përkohshëm Penal të Kosovës), përcakton se ndjekja penale ndalohet në çdo rast kur të ketë kaluar dyfishi i kohës së afatit të parashkrimit (ndalesa absolute e ndjekjes penale), ku në rastin konkret ndalesa absolute i bie që të jetë afati kohorë 10 vjeçar.

Me shqyrtimin dhe verifikimin e aktakuzës së lartë - theksuar dhe provave tjera të cilat gjenden në shkresat e lëndës, është vërtetuar se i akuzuari E.C. ka kryer veprën penale për të cilën akuzohet në periudhën kohore nga viti 2007 deri në vitin 2008. Meqenëse si kohë e fundit e kryerjes së veprës penale apo kohë e veprimit të fundit të ndërmarrë, konsiderohet viti 2008, e ku data e saktë e veprimit të fundit nuk është theksuar por vetëm viti 2008, datë e fundit e ndërmarrjes së veprimeve konsiderohet data 31 dhjetor 2008.

Marrë në konsideratë faktin se nga koha e kryerjes së veprave penale (31 dhjetori 2008, kur është ndërmarrë veprimi i fundit në drejtim të kryerjes së veprës penale), kanë kaluar mbi 10 (dhjetë) vjet, respektivisht dyfishi i kohës së parashkrimit relativ, andaj ndjekja penale nuk mundë të ndërmerret për shkak të parashkrimit absolut të ndjekjes penale.

Nga arsyet e cekura më lartë u vendos si në dispozitiv të këtij aktvendimi e në harmoni me nenin 90 paragrafi 1 pika 4 e nenin 91 paragrafi 6 të KPK (Kodit Përkohshëm Penal të Kosovës) dhe nenin 249 paragrafi 2 lidhur me paragrafin 1 lidhur me nenin 31 të KPK (Kodit Penal të Përkohshëm).

Vendimi mbi udhëzimin e palës së dëmtuar në kontest civil për realizimin e kërkesës pasurore juridike, është marrë në harmoni me nenin 463 të KPPK.

Vendimi mbi shpenzimet procedurës penale është marrë në kuptim të nenit 454 të KPPK.

GJYKATA THEMELORE NË PRISHTINË
DEPARTAMENTI SPECIAL
PS.nr.41/2019 datë 8 qershor 2020

Kryetari i Trupit Gjykses,
Valon Kurtaj

UDHËZIM JURIDIK: kundër këtij aktvendimi lejohet ankesa në afat prej 3 (tri) ditëve nga dita e pranimit të të njëjtit, Gjykatës së Apelit - Departamenti Special në Prishtinë, nëpërmjet Gjykatës Themelore - Departamenti Special në Prishtinë.